



## Kërkesë për informacion rreth ndalim-hyrjeve në Gjermani apo në vendet e Schengen-it

Për të mësuar, nëse ndaj jush është marrë një masë ndalim-hyrjeje dhe se cila zyrë e ka marrë këtë masë ju mund t'i drejtoheni me shkrim me kërkesën bashkëngjitur direkt autoritetit përgjegjës. **Për fat të keq Ambasada në këto raste nuk mund të ndihmojë.** Kërkesa për informacion duhet të jetë në gjuhën gjermane, nënshkrimi duhet të jetë i noterizuar nga një ent zyrtar dhe duhet të ketë bashkëngjitur një fotoopje të noterizuar të pashaportës së personit në fjalë.

Rekordet në Regjistrin Qendror të të huajve	Njoftimet në Sistemin e Informacionit të Vendeve Schengen
<p>Sipas § 11 kreu 1 i Ligjit për të Huajt shtetasit e huaj, që janë dëbuar apo larguar nga Republika Federale e Gjermanisë nuk lejohet të hynë sërish në territorin federal dhe të qëndrojnë atje.</p> <p>Rezervat e autoriteteve federale gjermane lidhur me hyrjen në vend të një shtetasi të huaj shënohen në parim pa afat në Regjistrin Qendror të të Huajve. Personi në fjalë mund të depozitojë një kërkesë për vënien në afat apo pezullimin e rezervave të autoriteteve lidhur me hyrjen e tij në vend, dhe këtë mund ta bëjë vetëm <u>direkt pranë zyrës që ka iniciuar regjistrimin e të dhënave në fjalë</u>. Informacione rreth zyrës që ka lëshuar urdhrin mund të merren pranë:</p> <p><b>Bundesverwaltungsamt</b>  <b>- Ausländerzentralregister -</b>  <b>Postfach 68 01 69</b>  <b>50728 Köln</b>  <b>Tel.: 81049-1888-358-1351 oder 358-3351</b>  <b>Fax: 81049-1888-358-2831</b></p> <p>Për arsye të mbrojtjes së informacionit informacioni i kalohet vetëm personit të prekur. Nëse masa e ndalim-hyrjes është pa afat, kërkesa për të vënë në afat a posteriori efektin e masës së dëbimit i drejtohet zyrës, që ka urdhëruar largimin përkatësisht dëbimin nga vendi. Është kompetencë e kësaj zyre të vendosë për vënien në afat të ndalim-hyrjes.</p>	<p>Sipas Art. 5 kreu. 1 i SÜD shtetasit e huaj, të cilët janë regjistruar në sistem me masën e ndalim-hyrjes nga njëri prej shteteve palë të Marrëveshjes, nuk lejohet të hynë në hapësirën e Marrëveshjes Schengen. Njoftimet e autoriteteve kombëtare të të gjitha shteteve anëtare të SCHENGEN-it hidhen në Sistemin e Informacionit të Schengen-it. Nëse aplikimi juaj për vizë refuzohet nga Ambasada Gjermane për shkak të një njoftimi në SIS atëherë drejtohuni pranë:</p> <p><b>Bundeskriminalamt</b>  <b>SIRENE Deutschland (ZD12)</b>  <b>Thaerstr. 11</b>  <b>65173 Wiesbaden</b>  <b>Tel: 81049-611-55-16511</b>  <b>Fax: 81049-611-55-16531</b>  <b>e-mail: operation@bka.bund.de</b></p> <p>Rihyrja në territorin federal apo në vendet Schengen nuk është e mundur për sa kohë që ndaj jush figurojnë rezerva lidhur me hyrjen në vend. Gjatë kësaj periudhe ju nuk lejoheni të kaloni as tranzit përmes Republikës Federale të Gjermanisë, as të qëndroni atje për qëllime turistike apo punësimi. Sipas § 95 kreu 2 Nr. 1 i Ligjit për të Huajt, nëse do të hynit në Territorin Federal apo do të qëndronit atje edhe pse ndaj jush ekziston masa e ndalim-hyrjes, atëherë do të dënoheshit me heqje lirie deri në tre vjet.</p>
<p><b>Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:</b>  Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.</p>	